

FUNKSIONET DHE DETYRAT E AUTORITETIT PUBLIK

- OBP sh.a. është organ qendror blerës, misioni i të cilit konsiston në kryerjen e procedurave të përqendruara të prokurimit për mallra, punë, shërbime, të fondeve buxhetore me vlerë mbi kufirin monetar të prokurimeve me vlera të vogla, në emër dhe për llogari të Kryeministrit, ministrave, institucioneve në varësi të Kryeministrit e të ministrave të linjës.

- Operatori i Blerjeve të Përqendruara, si organ qendror blerës, zhvillon procedurat në fushën e prokurimit të mallrave, shërbimeve dhe punëve, si më poshtë vijon:

a) blerje automjete;

b) blerje karburanti, me përjashtim të vajgurit Jet A1 dhe karburantit që prokurohet për përdorim nga fermerët;

c) blerje materialesh kancelarie;

ç) blerje orendish dhe pajisjesh për mobilim;

d) blerje materialesh të ndryshme për pastrim;

dh) blerje uniformash dhe elementesh të tjera përbërëse të tyre;

e) blerje këpucësh;

ë) blerje pjesësh këmbimi për automjete, për shërbimet profilaktike;

f) blerje tonerash;

g) shërbime në fushën e sigurimeve, si:

i. sigurim i automjeteve;

ii. sigurim i mjeteve lundruese;

iii. sigurim i mjeteve ajrore;

iv. sigurim jete dhe shëndeti;

v. sigurim i godinave publike;

gj) shërbim gatimi dhe shpërndarjeje ushqimi;

h) shërbim pastrimi;

i) shërbim lavanderie;

j) shërbim lysterjeje dhe mirëmbajtjeje të ndërtesave publike;

k) riparim dhe mirëmbajtjeje automjete;

- l) botime, printime dhe materiale shtypshkrimi;
- ll) blerje materialesh të buta dhe veshmbathjesh;
- m) riparim e mirëmbajtje sistemesh të ngrohje-ftohjeve;
- n) blerje pajisjesh laboratorike, si dhe mjetesh didaktike, të lidhura me proceset e tyre të punës, me përjashtim të atyre mjekësore;
- nj) shërbime dezinfektimi, deratizimi dhe dezinfektimi;
- o) blerje artikujsh ushqimorë;
- p) blerje pajisjesh kondicionimi;
- q) shërbim gjelbërimi;
- r) rikonstruksion objektsh.

- OBP sh.a., me kërkesë të një apo të disa autoriteteve/enteve kontraktore, zhvillon procedura prokurimi edhe për punë/mallra/shërbime, të cilat nuk janë listuar në pikën 11, të këtij vendimi, në rastet kur autoriteti/enti kontraktor kërkues nuk ka kapacitete apo njohuri të mjaftueshme për realizimin e një procedure prokurimi.

- Shoqëria aksionare financohet nga të ardhurat e veta, të ardhura nga shërbimet ndaj të tretëve, të konsulencës, nga ofrimi i shërbimeve dhe burime të tjera të ligjshme. Të ardhurat e shoqërisë aksionare përdoren për ushtrimin e veprimtarisë së saj. 17. Shoqëria aksionare mund të ofrojë shërbime të tjera shtesë për subjekte publike dhe private, në përputhje me qëllimin e krijimit, fushën e veprimtarisë dhe statutin e saj.